

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Komisioni për Arsim, Shkencë,
Teknologji, Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja e datës 30.08.2007
Salla nr. C- 301, ora: 12:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Enver Hoxhaj, Nimon Alimusaj, Remzije Nimani, Gjylshene Berisha, Ragip Zekolli, Drita Statovci, Sala Ahmetaj, Myrvete Dreshaj, Genc Gorani, Naxhije Doçi dhe Ramë Buja, ndërsa munguan: Gojko Saviq, Mark Krasniqi dhe Nuran Malta.

Nga sekretaria e Kuvendit mori pjesë: Mirjeta Heta.

Mbledhjen e udhëhoqi, Enver Hoxhaj - kryetar i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Nxjerrja e Rekomandimeve për Rininë;
3. Të ndryshme.

Pika e parë e rendit të ditës –

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

Pika e dytë e rendit të ditës –

Për këtë pikë të rendit të ditës, Komisioni vendosi që të shtyhet për mbledhjen e radhës e cila do të mbahet me 31 gusht 2007.

Pika e tretë e rendit të ditës –

Në këtë pikë Komisioni debatoi lidhur me Listën e propozuar nga MKRS-ja për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore.

Rekomandimi i nxjerrur nga Komisioni në mbledhjen e dt.18.07.07, nuk është proceduar mëtutje, ngase në Listën e propozuar nga MKRS-ja për emërimin e anëtarëve të Këshillit për Trashëgiminë Kulturore janë të kandiduar tetë anëtar, një anëtar më shumë sesa është paraparë në Ligjin për Trashëgiminë Kulturore.

Lidhur me këtë çështje debatuan : E. Hoxhaj, N.Alimusaj , R. Nimani, Gj.Berisha, G. Gorani, R.Buja , S. Ahmetaj, R. Zekolli dhe N. Doçi, pasi që të gjithë anëtarët e Komisionit ndanin mendimin e njëjtë lidhur me këtë listë të propozuar nga MKRS, njëzëri vendosen që Minisitrisë në fjalë ti sugjerojnë si vijon :

- Anëtarët e propozuar për Këshill të Trashëgimisë Kulturore të mos jenë anëtarë edhe në borde tjera.
- Anëtari i deleguar nga AKSHAK-ja të zëvendësohet me anëtarin e propozuar nga Instituti Albanologjik i Kosovës.
- Anëtari i deleguar nga Instituti i Historisë të zëvendësohet me një anëtar të propozuar nga Muzeu i Kosovës, Instituti Arkeologjik ose nga Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kosovës.
- Të kompletohet Lista e anëtarëve të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore me biografite të tyre dhe të sjellën në gjuhët zyrtare të Kuvendit të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në ora: 13:00.

Kryetari i Komisionit:

Enver Hoxhaj